



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:069770
Datë: 20.06.2024
Numri i dokumentit: 05838777

SCC-09-0116

S V Z nga Laplla Sela.

Paditësi:

Kundër

E paditura:

N.SH “Kosova - Export”, e përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. “Dritan Hoxha”, Nr. 55, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, sipas gjyqtarit Dr.sc.Murat Hulaj, me dt.18 qershor 2024, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

- HEDHET POSHTË** si e pa pranueshme, padia e paditësit e paraqitur kundër të paditurës N.SH “Kosova – Export” e përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit.
- Secila palë i bart shpenzimet e veta.**

Rrethanat faktike dhe procedurale:

Me dt.02 korrik 2009, paditësi paraqiti padi në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, me të cilën ka kërkuar që të bëhet vërtetimi i pronësisë për ngastrat kadastrale nr.. dhe nr.. Z.K. Laplje Sela.

Me dt.25 shtator 2023, gjykata lëshoj urdhër për dhe kërkoi nga paditësi që brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, të parashtrorj në gjykatë “Dëshmi (Aktvendimin e trashëgimisë), për të vërtetuar legjitimitetin real aktiv të paditësit në procedurë. Po ashtu paditësi është njoftuar se nëse nuk e përmbushi urdhrin, atëherë ankesa do të hedhet poshtë si e pa pranueshme.

Pas dështimit të dorëzimit – pranimit të dokumentit në bazë të nenit 26 par.5 të Ligjit nr.06/L-086 për DHPGJS, nenit 116 par.5 dhe nenit 116 par.6 të LPK-së, gjyqtari i DHPGJS urdhëron zyrën e regjistrat që të afishoj (publikoj) në Tabelën e Shpalljeve, Vërejtje për pagesën e taksave gjyqësore.

Kjo shpallje qëndroi në tabelë nga dt.20 tetor 2023 deri me dt.31 tetor 2023.

Arsyetimi ligjor:

Padia e paditësit hedhet poshtë si e papranueshme.

Në kuptim të nenit 76.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktvendim pa caktuar seancë dëgjimore.

Me nenin 33 dhe nenin 35 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, ndër të tjera rregullojnë parashtrimin e kërkesave përkatësisht ankesave dhe nisjen e procedurave në Dhomën e Posaçme. Kurse neni 35 par.2 i po këtij ligji më tej përcakton se çfarë duhet të përmbaj një kërkesë apo ankesë.

Neni 36 par.2 pika 2.5 i Ligjit për Dhomën e Posaçme parasheh që: “Një kërkesë/ankesë është e pranueshme nëse: kërkesa/ankesa është parashtruar në pajtim me nenin 33 të kësaj shtojce dhe është në përputhje me dispozitat e nenit 35 të kësaj shtojce.”

Kjo gjykatë konstaton se padia e paditësit është në kundërshtim me parimin procedural “legitimacio ad causam”, duke u bazuar në nenin 73 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (Ligji nr. 03/L-006-LPK), nga aftësitë e të qenurit palë, gjithnjë duhet shikuar edhe “legjitimitetin real” i cili paraqet raportin materialo-juridik të palëve ndaj objektit të kërkesëpadisë.

Paditësi e gëzon legjitimitetin aktiv gjithnjë nëse është bartës të së drejtës e cila është objekt i kërkesëpadisë. Paditësit i’u kërkua që të parashtrorj Aktvendimin mbi trashëgimin, për të dëshmuar të drejtën për të kërkuar njohjen e së drejtës kontestuese.

Në bazë të nenit 14 par.4 të Ligjit mbi DHPGJS, në pajtim me nenin 73 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (Ligji nr. 03/L066), pasi që paditësi dështuan të parashtrorj Aktvendimin mbi Trashëgiminë, ishte e pamundur për gjykatën që të konstituoje legjitimitetin aktiv dhe të vazhdojë procedurën.

Bazuar në dispozitat e theksuara, kjo gjykatë vjen në përfundim se padia e paditësit duhet të hedhet poshtë si e pabazuar për shkak të mungesës së legjitimitetit të palës paditëse.

Gjykata lëshoj urdhrin e dt. 25 shtator 2023, ku përmes tij kërkoj nga pala që të sjell vendimin mbi trashëgiminë dhe ia tërhoqi vërejtjen për pasojat e mos ofrimit të një vendimi të tillë. Andaj, kjo gjykatë konsideron se mungesa e legjitimitetit të palëve ka si pasojë hedhjen poshtë të padisë. Në këtë situatë, është e qartë se në këtë çështje juridike, mungon legjitimiteti aktiv i paditësit, andaj padia hedhet si e papranueshme në mënyrë që ti jepet paditësit edhe një mundësi në krijimin e kushteve ligjore për një procedurë të rregullt dhe ligjore.

Për këtë, në pajtim me nenet 36 par.1, dhe par.3, dhe 74 par.2, të Ligjit për Dhomën e Posaçme, padia e paditësit hedhet poshtë si e papranueshme.

Shpenzimet gjyqësore:

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta.

Këshillë juridike:

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

G j y q t a r i,
Dr.sc. Murat Hulaj,
